



05/04/2023

Vlorë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Selevec”

Vlorë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Selevec".

Falë ndërhyrjes në kohë nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i një konflikti me armë zjarri.

Vihet në pranga një 58-vjeçar që kanosi me armë zjarri pistoletë, bashkëfshatarin e tij, pas një konflikti për motive pronësie, në fshatin Panaja.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, pas marrjes së njoftimit për një konflikt me armë zjarri, në fshatin Panaja, në vendin e quajtur "Selevec", kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Selevec", për parandalimin e përkallëzimit të konfliktit.

Në kuadër të këtij operacioni, falë ndërhyrjes në kohë të shërbimeve të Policisë u bë i mundur parandalimi përshkallëzimit të konfliktit dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

- A. S., 58 vjeç, banues në fshati Oshtimë, Vlorë.

Shtetasi A. S., gjatë një konflikti për motive pronësie, ka kanosur me armë zjarri pistoletë, shtetasin N. H., 58 vjeç, banues në fshatin Oshtimë, Vlorë.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan arma e zjarrit pistoletë dhe një sasi fishekësh.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent